



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:133512

Datë: 24.03.2025

Numri i dokumentit: 07033725

AA.nr.316/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrativ, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët, Hajriz Hoti kryetar i kolegjit, Ramiz Kuqi dhe Arsim Hamzaj anëtarë, e me bashkëpunëtoren profesionale, Hajrije Krasniqi, në çështjen e konfliktit administrativ sipas padisë së paditësit, Sh.J, kundër të paditurës, Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit me seli në Prishtinë, me bazë juridike anulim i vendimit, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A.nr.1693/2020, të datës 02.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë;12.03.2025, merr këtë,

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës, Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1693/2020, i datës; 02.02.2024, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1693/2020, të datës; 02.02.2024, është vendosur, *“I APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Sh.J. II ANULOHET vendimi i të paditurës Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Nr.2/1K-3538, i datës 06.10.2023, ashtu që APROVOHET si e bazuar ankesa e paditësit e parashtruar tek e paditura MASHT, me nr.1977, e datës 27.08.2020, dhe paditësi shpallet përfitues i bursës për studentet elitare për vitin akademik 2019-2020. III DETYROHET e paditura që të kompensoj paditësit shumën në lartësi prej 700 (shtatëqind) euro, në emër të bursës së porealizuar, dhe të njëjtën të deponoj në xhirollogarin bankare TEB nr.2020000157319719 të paditësit, në afat prej 15 ditësh, në pasojat e përmbarimit me dhunë. IV Secila palë i bartë shpenzimet e veta”*.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura ka ushtruar ankesë, përmes Avokaturës Shtetërore, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës administrative, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit të Kosovës ta aprovtojë ankesën, ta prishë aktgjykimin e ankimuar, të refuzohet kërkesëpadia e paditësit dhe të mbetet në fuqi vendimi i të paditurës.

Paditësi, Shpend Jahaj, nuk ka ushtruar përgjigje në ankesë.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre duke u bazuar në nenin 49 paragrafi 1 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe nenit 194 dhe 195.1 paragrafi d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, dhe ka gjetur se ankesa e të paditurës është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin e kontestuar, Nr.2/1K-3538 të datës 06.10.2023, ishte refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit e paraqitur kundër vendimit nr.01B-84 të datës 25.08.2020, e me këtë fundit nga e paditura ishin përcaktuar studentet përfitues të bursës për vitin akademik 2019/20, duke u paraqitur lista me emrat e përfituesve, pa përfshirë emrin e paditësit.

Paditësi i pa kënaqur me vendimin e të paditurës, ka ushtruar padi për konflikt administrativ më datë;13.10.2020, me të cilën ka kërkuar aprovimin e padisë dhe anulimin e vendimit të paditurës nga arsyet e dhëna në padi.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit të paraqitur kundër vendimit kontestues të paditurës, dhe administrimit të provave si në procesverbalin e seancës së shqyrtimit kryesor, bie aktgjykimin e ankimuar, me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e aprovon si të bazuar, me arsyetim se *“Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në përputhje me nenin 44 të LKA-së, dhe kështu pas vlerësimit të thënieve në padi, përgjigjes në padi, deklarimeve dhe shkresave të lëndës ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar. Nga vendimi i kontestuar, me Nr.2/1K-3538 të datës 06.10.2023, gjykata gjeti se ishte refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit e paraqitur kundër vendimit nr.01B-84 të datës 25.08.2020, e me këtë fundit nga e paditura ishin përcaktuar studentet përfitues të bursës për vitin akademik 2019/20, duke u paraqitur lista me emrat e përfituesve, pa përfshirë emrin e paditësit. Kështu kjo gjykatë për të vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar me padi, i'u referua Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr.14/17 për Ndarjen e Bursave, konkretisht dispozitës së nenit 3 Kushtet dhe Kriteret, e me të cilën është përcaktuar: 1 për fitimin e bursës së MASHT, kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte dhe kriteret bazë: 1.1 të jenë shtetas të Republikës së Kosovës; 1.2 të kenë notën mesatare të studimeve së paku (9); 1.3 të kenë përfunduar vitin e parë të studimeve në njërin nga institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës; 1.4 të kenë përfunduar vitet akademike paraprake; 1.5 fushat e studimit përcaktohen nga ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe 1.6 të dorëzojë së paku dy referenca të profesorëve, me të cilat dëshmohet merita dhe kompetenca e kandidatit. Më pas gjykata i'u referua, mori për bazë dhe shqyrtoi Konkursin për ndarjen e bursave për studentet elitare të Universiteteve publike të niveleve: Bachelor dhe Master për vitin akademik 2019-2020, të publikuar me datë 29.05.2020, dhe gjeti se me të njëjtin konkretisht ishte përcaktuar se kandidatet duhet: të jenë shtetas të Republikës së Kosovës; të kenë përfunduar vitin e parë në studimet BA dhe vitin e parë për studimet MA; të kenë përfunduar vitet akademike paraprake, pa përsëritje dhe të kenë notë mesatare të studimeve së paku 9.0 të arritur në afatin e provimeve të shtatorit të vitit 2019. Prandaj për të vlerësuar nëse paditësi kishte përmbushur kriteret ligjore si më lartë dhe ato të përcaktuara me konkurs, gjykata shqyrtoi provat e prezantuar nga paditësi dhe përmes tyre ka konstatuar, fillimisht, se paditësi ka aplikuar përmes sistemit elektronik të UP me datë 25.06.2020, brenda afatit të përcaktuar me konkurs. Më pas nga kopja e letërnjoftimit, me datë lëshimi 25.02.2016, u vërtetua se paditësi është shtetas i Republikës së Kosovës. Dhe në fund nga dëshmia Certifikata e notave, ref.nr.06/607, e datës 23.10. 2020, u vërtetua se paditësi studimet Master në Fakultetin Juridik– Programi Penal, i kishte regjistruar me datë 08.10.2018*

dhe kishte përfunduar provimet e këtij programi, 1 semestër, me datë 02.07.2019, me notë mesatare 9.70. Pra bazuar në provat e shqyrtuar, vërtetohet se paditësi si student në UP “Hasan Prishtinë”, si një nga Institucionit Publike të Arsimit të Lartë, kishte plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuar me ligj dhe konkursin e datës 29.05.2020, pra krahas kushteve të cilat nuk ishin kontestuese për të paditurën, u vërtetua se kishte të përfunduar dhe nuk kishte përsëritur vitin e parë të Studimeve Master, me notë mesatare 9.70. Pra nga kjo gjendje faktike e konstatuar nuk bëhet e ditur për gjykatën se si nga e paditura ishte konstatuar tjetër gjendje faktike dhe se si nga e njëjta ishte konstatuar se paditësi nuk ka përmbushur kriteret e përcaktuar me nenin 3 paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 të UA nr.14/2017. Për më tepër arsytimi i dhënë në vendimin e kontestuar se: “bazuar në dokumentacionin e ofruar nga Departamenti i Arsimit të Lartë në MASHT, të gjithë përfituesit e bursës elitare ishin master dy vjeçar, ndërsa master një vjeçar të gjithë aplikuesit për bursë ishin refuzuar nga komisioni vlerësues”, për gjykatën paraqet arsyetim të pakuptimtë, të pa qartë dhe të pabazuar, kjo ngase Udhëzimi përkatës për ndarjen e bursave nuk kishte paraparë asnjë dispozitë të vetme që studentet e nivelit maser, me sistem një vjeçar, ti përjashtoj si kategori e përfituesve të bursave. Gjykata shqyrtoi edhe pretendimet e përfaqësuesve të të paditurës të dhëna në përgjigjen në padi, mirëpo të njëjta i refuzoi si të pabazuar dhe të paqëndrueshme. Prandaj duke e gjitha e konstatuar si më lartë kjo gjykatë duke u bazuar në nenin 46 paragrafi 4 të LKA, ka vendosur vetë për çështjen administrative si në paragrafin 1 dhe 2 të këtij aktgjykimi, ashtu që ka anuluar aktin e kontestuar të paditurës nr.2/1K-3538 të datës 06.10.2023 dhe aprovuar si të bazuar ankesën e paditësit me nr.1977, të datës 27.08.2020 duke e shpallur të njëjtin fitues të bursës. Po ashtu mbi bazën e nenit 46 paragrafi 5, lidhur me nenin 17 dhe 26 të të njëjtit ligj në të cilën është përcaktuar se me padi mund të kërkohet dhe kompensimi i dëmit që i është shkaktuar paditësit me ekzekutimin e aktit që kontestohet, kjo gjykatë ka vendosur si në paragrafin 3 të këtij aktgjykimi, pasi që ka konstatuar se ekzekutimi i vendimit të kontestuar dhe i anuluar me këtë aktgjykim paditësit i ka shkaktuar dëm, përkatësisht i ka pamundësuar realizimin e bursës në shumën prej 700 euro si të përcaktuar me konkursin e publikuar me datë 29.05.2020”.

Qëndrimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kolegji i apelit, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe Ligjit për Procedurën Kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m), për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e rrjedhimisht edhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë.

Sa i përket pretendimit ankimor se Gjykata e shkallës së parë, ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës administrative, sipas vlerësimit të kolegjit ky pretendim nuk qëndron, ngase e paditura të njëjtës shkelje vetëm iu ka referuar si shkelje në hyrje të ankesës, por nuk ka theksuar saktë se ku qëndrojnë shkeljet e dispozitave procedurale, megjithatë kolegji i apelit vëren se Gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht i ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit të vendimit Gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LPPA-së, LKA-së, dhe se aktgjykimi është hartuar në pajtim me nenin 160 të LPK-së.

Sa i përket pretendimit ankimor për konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, se “Konstatimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike konsiston në faktin se gjykata gjatë shqyrtimit të çështjes administrative nuk mori parasysh faktet e rëndësishme për zgjedhjen e çështjes”. Kolegji i apelit duke i vlerësuar këto pretendime ankimore, vëren se gjendja e vërtetuar faktike nga ana e Gjykatës të shkallës së parë nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore, kjo

për faktin se Gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e të paditurës janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme, kur ka konstatuar se *“Pra bazuar në provat e shqyrtuar, vërtetohet se paditësi si student në UP “Hasan Prishtinë”, si një nga Institucionit Publike të Arsimit të Lartë, kishte plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuar me ligj dhe konkursin e datës 29.05.2020, pra krahas kushteve të cilat nuk ishin kontestuese për të paditurën, u vërtetua se kishte të përfunduar dhe nuk kishte përsëritur vitin e parë të Studimeve Master, me notë mesatare 9.70. Pra nga kjo gjendje faktike e konstatuar nuk bëhet e ditur për gjykatën se si nga e paditura ishte konstatuar tjetër gjendje faktike dhe se si nga e njëjta ishte konstatuar se paditësi nuk ka përmbushur kriteret e përcaktuar me nenin 3 paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 të UA nr.14/2017. Për më tepër arsytimi i dhënë në vendimin e kontestuar se: “bazuar në dokumentacionin e ofruar nga Departamenti i Arsimit të Lartë në MASHT, të gjithë përfituesit e bursës elitare ishin master dy vjeçar, ndërsa master një vjeçar të gjithë aplikuesit për bursë ishin refuzuar nga komisioni vlerësues”, për gjykatën paraqet arsytim të pakuptimtë, të pa qartë dhe të pabazuar, kjo ngase Udhëzimi përkatës për ndarjen e bursave nuk kishte paraparë asnjë dispozitë të vetme që studentet e nivelit maser, me sistem një vjeçar, ti përjashtoj si kategori e përfituesve të bursave”.*

Gjendja e vërtetuar faktike nga ana e gjykatës të shkallës së parë, nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore, kjo për faktin se aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave procedurale dhe konstatim të gabuar të gjendjes faktike. Gjithashtu aktgjykimi është bazuar në zbatim të drejtë të së drejtës materiale konkretisht nenit 3, të Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr.14/17 për Ndarjen e Bursave.

Mbi këto arsye kolegji i apelit pretendimet ankimore i konsideron si të pa bazuara, prandaj, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij janë dhënë arsyet e mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kolegji i apelit.

Duke vlerësuar se Gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar të drejtën materiale me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, dhe mbi këtë bazë ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këto arsye, e në mbështetje të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative, lidhur me nenin 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.316/2024, datë 12.03.2025

Kryetari i kolegjit,
Hajriz Hoti